



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

2 shkurt 2022

RrGK kërkon zbatimin e Rezolutës 1325 në Dialog

I nderuari Përfaqësues Special i BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë, Z. Miroslav Lajčák:
I nderuari shëf i Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuesi Special i BE-së, Ambasadori Tomáš Szunyog:

Këtë javë Z. Lajčák është takuar me disa zyrtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë në lidhje me dialogun Serbi-Kosovë. Po ju shkruajmë që të shprehim shqetësimin tonë të thellë që, as kësaj herë, as Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe, sipas dijes sonë, asnjë aktivist/e që përfaqëson organizatat për të drejtat e grave (OShCG-të) nuk është ftuar në këto diskutime. Përkundër bashkëpunimit tonë të ngushtë të vazhdueshëm me BE-në si partner kyç në shumë fronte të tjera, përfshirë edhe bashkëpunimin specifik në lidhje me angazhimin politik të grave, ne nuk jemi informuar nëse ndonjë OShCG është ftuar e as nuk jemi informuar lidhur me atë se deri në cilën shkallë agjenda e këtij dialogu përfshin barazinë gjinore dhe çështjet që gratë e Kosovës i konsiderojnë prioritet për dialogun.

RrGK është rrjet multi-etnik i përbërë prej 189 organizatave për të drejtat e grave nga mbarë Kosova, përfshirë gra shqiptare, serbe, rome, ashkallike, egjiptiane, turke, boshnjake dhe gorane. Anëtarët tona përfshijnë gra nga zonat rurale dhe urbane të aftësive, feve dhe pozitive të ndryshme në Kosovë. Ne njihemi në mesin e rrjeteve më të mëdha dhe më të fuqishme të shoqërisë civile në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Si rrjet formal, kemi qenë të angazhuara në proceset e drejtësisë dhe paqes tranzicionale që nga koha kur u formuam në vitin 2000, e po ashtu dhe Rrjeti i Grave Rurale që përfundimisht u zgjerua dhe u dhe shndërrua në RrGK, ka qenë i përfshirë në proceset e paqes në ish-Jugosllavi që nga viti 1996. Ne kemi punuar për ngritjen e zërit të grave në negociata dhe proceset e paqes, kjo përmes dialogjeve paralele dhe letrave të hapura të publikuara në media, të cilat theksonin prioritetet e grave në aso kohe kur gratë vazhdimisht mbetën jashtë negociatave dhe dialogjeve gjatë dy dekadave të fundit. Përveç përvojës sonë të gjerë në ndërtimin e paqes, ne kemi botuar katër raporte dhe disa dokumente në lidhje me procesin e paqes, së fundi, duke përfshirë raportin "[Një ulëse në tryezë](#)", që përfshin zëra të ndryshëm të grave dhe rekomandime për dialogun, bazuar në hulumtimet dhe bisedat e gjëra me gratë e të gjitha etnive.

Jemi thellësisht të shqetësuar që edhe kësaj here Z. Lajčák dhe ekipi i tij, si dhe ata që janë të angazhuar në organizimin e kësaj vizite, nuk e kanë parë të nevojshme që të përfshijnë RrGK-në, OShCG-të ose aktivistet për të drejtat e grave në mesin e personave të konsultuar, kjo pavarësisht anëtarësisë sonë të gjerë e të larmishme, njohurisë sonë të gjerë mbi këtë temë dhe viteve të përvojës në këtë fushë. Shoqëria civile e Kosovës është shumë e gjallë, me

njohuri dhe përvoja, andaj edhe kontributi i aktivisteve për të drejtat e grave nuk duhet të nënvlerësohet gjatë diskutimeve të një rëndësie të tillë.

Duam të rikujtojmë se Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, dhe disa nga rezolutat e saj simotra, si dhe Qasja Strategjike e BE-së ndaj Grave, Paqes dhe Sigurisë, të gjitha qartazi kërkojnë konsultime me grupet për të drejtat e grave, si dhe përfshirjen e drejtpërdrejtë të grave në proceset e paqes. Ne e dimë se disa gra lidere si Presidentja Atifete Jahjaga, Edita Tahiri dhe Vlora Çitaku kanë qenë pjesë në vendimmarrjen lidhur me proceset e paqes. Megjithatë, gratë kanë qenë në mënyrë të konsiderueshme të nën-përfaqësuar në mesin e ekspertëve dhe në konsultime me gra dhe burra të ndryshëm në përgjithësi (*p.sh., si pjesë e diplomacisë së pistës së II-të*). Për më tepër, në dialogun e fundit të ndërmjetësuar nga BE-ja, mungon pjesëmarrja e grave dhe pikëpamjet e tyre nuk janë marrë parasysh aq sa duhet. Siç ju kemi informuar më parë, ne mbetemi të gatshme të sugjerojmë persona të kualifikuar, si dhe të mbështesim organizimin e konsultimeve publike, në drejtim të një procesi më transparent, gjithëpërfshirës si dhe drejt paqes së qëndrueshme. Përvoja në mbarë botën sugjeron se përfshirja e grave në proceset e paqes mund të kontribuojë në paqen e qëndrueshme, siç edhe është pranuar nga RKSKB dhe *Qasja Strategjike e BE-së*.

Përderisa ne, OShCG-të, dhe gratë në përgjithësi, vazhdojmë të jemi të marginalizuara nga këto procese dhe konsultime të rëndësishme, ne dëshirojmë të ndajmë me ju pikat kryesore të ngritura nga 434 gra nga grupe të ndryshme etnike të konsultuara për hartimin e raportit [Një Ulëse në Tryezë](#):

- I. Sigurimi i pjesëmarrjes cilësore të grave në proceset vendimmarrëse në lidhje me dialogun, kjo përmes pjesëmarrjes në ekipet zyrtare të negociatave, si eksperte dhe përmes konsultimeve publike me gra dhe OShCG të ndryshme; konsideroni fuqimisht përfshirjen e OShCG-ve udhëheqëse me anëtarësi të gjerë nga Kosova dhe Serbia në ekipet negociuese për të shtyrë përpara negociatat;
- II. Sigurimi i kthimit dhe/ose informacioneve transparente dhe të sakta në lidhje me fatin e të gjithë personave të zhdukur të të gjitha etnive;
- III. Të kërkohej nga Serbia që të njohë publikisht dhe të kërkojë falje për krimet e dokumentuara qartë të kryera kundër civilëve nga shteti;
- IV. Të sigurohet ndjekja penale e të gjithë personave që kanë kryer krime lufte, përfshirë dhunën seksuale të kryer gjatë luftës, duke siguruar në këtë mënyrë drejtësinë në përputhje me Rezolutën 1325 të KS të KB-së; si dhe
- V. Sigurimi i kompensimit dhe dëmshpërblimeve për shkatërrimin e mjeteve të jetesës së civilëve nga aktorët përgjegjës të qeverisë, duke përfshirë kthimin e pensioneve për popullin e Kosovës.

RrGK do të vazhdojë të monitorojë zbatimin e Rezolutës 1325 nga BE-ja, Qeveria e Kosovës dhe palët e tjera të interesuara. Ne kemi shpresa të mëdha që BE-ja, si partner yni do të sigurojë një proces demokratik, transparent, të përgjegjshëm gjinor dhe gjithëpërfshirës, i cili është thelbësor për paqen dhe sigurinë e qëndrueshme në Kosovë, Serbi dhe në rajon. Ju faleminderit për vëmendjen tuaj dhe veprimin e menjëhershëm për të adresuar këto çështje.

Sinqerisht,
Igballe Rogova
Drejtoresh Ekzekutive
Rrjeti i Grave të Kosovës